

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU
---	--	--

20 mars 2013

SCC-11-0226

Paditësit

- 1. M.D.D. XX**
- 2. M.D.D., XX**

Të dytë përfaqësohen nga avokati XX, XX

Kundër

Të Paditura

- 1. Gjykata Supreme e Kosovës, Prishtinë**
- 2. M.P.M., XX**
- 3. NSH XX, XX**

Kolegji i Specializuar në përbërje prej Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Çerim Fazliji, Gjyqtarë, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Padia dhe Kërkesa për Urdhër Paraprak Gjyqësor refuzohen si të papranueshme.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

04 dhjetor 2006, Paditësi ka parashtruar padi pronësore, SCC-06-0498 në Dhomën e Posaçme duke kërkuar kthimin e patundshmërisë, ngastrën kadastrale nr. 1536/1 Fleta Poseduese 4011 e cila ishte nacionalizuar për formimin e Kooperativës Bujqësore Kosova me seli në Uglarë- Fushë Kosovë. Me 31 janar 2007, Dhoma e Posaçme e ka ceduar lëndën për gjykim në Gjykatën Komunale të Prishtinës duke mbajtur juridiksion për ndonjë ankesë kundër aktgjykimit apo aktvendimit të saj. Me 16 prill 2007 Gjykata Komunale në Prishtinë ka marrë aktgjykimin P. 236/97. Me 13 dhjetor 2007, pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, Cml-Gzz nr. 36/2007 ka vendosur që aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 16 prill 2007 të anulohet dhe që lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Me 22 qershor 2012, dosja e Gjykatës Komunale të Prishtinës P. 3/08 (procedura e përsëritur e P. 236/97) i është përcjellë Dhomës së Posaçme (Neni 4.4 i LDHP-së) dhe është regjistruar me numër C-III-12-1095.

Me 3 tetor 2011, Paditësit kanë parashtruar padi, SCC-11-0226, duke kërkuar që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë P. 236/97 i datës 16 prill 2007 të vërtetohet nga Dhoma e Posaçme. Paditësit deklarojnë se ky aktgjykim nuk është ankimuar andaj edhe është bërë i plotfuqishëm me 5 maj 2007. Paditësit po ashtu kërkojnë që Aktvendimi i Gjykatës Supreme Cml-Gzz. nr 36/2007 të shpallet nul dhe i pavlerë. Ata debatojnë se Gjykata Supreme nuk ka juridiksion për rishqyrtimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale P. 236.97 sepse sipas Vendimit për referim SCC-06-0498, Dhoma e Posaçme ruan juridiksionin ekskluziv për ndonjë apel kundër aktvendimit apo aktgjykimit të shkallës së parë.

Me 4 mars 2013, Paditësit kanë parashtruar kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor kundër të Paditurës 2 dhe të Paditurës 3 dhe për bashkim të dosjeve C-III-12-1095 dhe C-III-12-1100 (padia për një pjesë të ngastrës së kontestuar) me SCC-11-0226.

Lidhur me hollësitë tjera të padisë, orientohuni në dosjen e lëndës në Dhomën e Posaçme.

Arsyet ligjore

Padia dhe Kërkesa për Urdhër Paraprak Gjyqësor janë të papranueshme sepse Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion për këtë lëndë.

Papranueshmria lidhur me të Paditurat 1 dhe 2.

Neni 5.2 i Ligjit 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme (LDHP) përcakton:

2. Palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme janë:

2.1. në kuptimin e kërkesës së përcaktuar me nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.6 apo 1.7 të nenit 4 të këtij ligji: Agjencia.

2.2. në kuptimin e kërkesës së përcaktuar me nën-paragrafët 1.4 apo 1.5 të nenit 4 të këtij ligji: sipas zgjedhjes së Agjencisë, Ndërmarrja/Korporata në fjalë, apo Agjencia duke vepruar në emër të Ndërmarrjes/Korporatës në fjalë;

2.3. në kuptimin e parashtrësës për anulim të parashtruar apo dorëzuar nga Agjencia, si dhe përcaktuar me nën-paragrafin 1.8 të nenit 4 të këtij ligji: personi(at) që kanë interes material në transaksionin që i nënshtrohet një parashtrësë të tillë;

2.4. në kuptimin e parashtrësës për ushtrim të dorëzuar nga Agjencia, si dhe përcaktuar me nën-paragrafin 1.9 të nenit 4 të këtij ligji: personi(at) që i nënshtrohen asaj parashtrësë; si dhe

2.5. në kuptimin e cilitdo rast apo çështje para saj: secili person të cilin Dhoma e Posaçme apo ndonjë kolegji i saj e konsideron të domosdoshëm apo të përshtatshëm për ta pranuar si Palë Kundërshtare me qëllim të sigurimit të gjyqimit të plotë dhe të saktë të rastit apo çështjes në fjalë.

Të Paditurat 1 dhe 2 nuk janë të Paditurat e mundshme në Dhomën e Posaçme dhe ato po ashtu nuk mund të pranohen sipas nenit 5.2.5 të LDHP-së. Kjo dispozitë aplikohet vetëm kur së paku një e paditur e pranueshme merr pjesë në procedurë. Kjo nuk vlen këtu sepse përderisa e Paditura 3 është e paditur e pranueshme, padia kundër saj është e papranueshme.

Papranueshmeria lidhur me të Paditurës 3:

Gjykata gjen se padia fillimisht ishte parashtruar me 4 dhjetor 2006, SCC-06-0498, në Dhomën e Posaçme, siç i është ceduar Gjykatës Komunale në Prishtinë, është ende në zgjidhje e sipër, sepse ajo nuk është vendosur me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës. Në bazë të Nenit 4.4 të LDHP-së, lënda i është kthyer Dhomës së Posaçme nga Gjykata Komunale e Prishtinës, dhe se tani pret zgjidhje nën numër të lëndës C-III-12-1095. Dy nga Paditësit në këtë lëndë e kanë parashtruar këtë padi duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës i cili është prapësuar nga Gjykata Supreme me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Mirëpo, pasi që lënda fillestare ende pret zgjidhje dhe se është parashtruar para kësaj lëndë, kjo e fundit është dashur të hedhet poshtë nën kuptim të Neneve 262.3 dhe 262.4 të Ligjit Nr 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, i cili përcakton:

262.3 Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë.

262.4 Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.

Padia, për këtë arsye, nuk i plotëson kërkesat e pranueshmërisë nga Neni 28.2 të LDHP-së dhe se refuzohet si e papranueshme. Në pajtim me këtë, edhe Kërkesa për Urdhër Paraprak Gjyqësor është e papranueshme.

Shpenzimet

Gjykata nuk i përcakton shpenzimet për Paditësin pasi që Presidiumi i Gjykatës nuk ka nxjerrë ndonjë plan me shkrim i cili është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57, paragrafi 2 I Ligjit mbi Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri me tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për caktimin e shpenzimeve.

Këshilla ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'u dërgohet edhe palëve tjera dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek palëve tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I Padituri mund të parashtrrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek palëve tjera.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala

tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues

[nënshkruar]